

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GAMA INC"

Ky akt themelimi u përpilua nga ortakut i vetem themelues :

Majnela BEQIRI, e bija e Halit dhe Nurijs, e datëlindjes 24/05/1989, shtetase Shqiptare lindur në Elbasan dhe banuese në Kavajë, Shqipëri me adrese Lagjia Nr.5, Kavajë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , e pajisur me pasaporte me Nr.BA3418083 (Nr. Personal I95524124Q)

E quajtur më poshtë ortak themelues, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", sot më datë 29.01.2018 vendos të themelojë shoqërinë "GAMA INC" në bazë të kushteve që vijojnë:


KREU I
OBJEKTI, EMËRTIMI, FORMA JURIDIKE, SELIA
DHE KOHËZGJATJA

Neni 1

Objekti

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet privat në fushën e:

Import-eksport me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike, elektrike, elektronike, pajisje hidrosanitare, etj. Prodhim materialesh ndertimi, pjese dhe makineri qe lidhen me to, etj. Prodhim dhe tregtime të materialeve të ndërtimit, prodhim dhe tregtimi i betoneve të ndryshme parafabrikate dhe elemente te ndërtimit, prodhimin e elementëve gjysëm fabrikat, prodhim dhe tregtim i dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini, franksionimeve të zhavorreve, shpime me sondë etj. Import-eksport dhe shitje të pajisjeve hidrosanitare, pllakave dhe materialeve hidraulike (tubo, rakorderi, pompa uji, pajisje hidraulike për vaditje etj.) për përdorim civil dhe industrial. Prodhim Dizenjimi Tregtimi i mobiljeve, shtrim parketi, arredim te ambjenteve te ndryshme etj. Tregtim pajisje elektrike dhe elektronike si dhe sherbimin per to. Shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjeseve te kembimit, të reja dhe të përdorura per automjete te transportit tokesor, detar, ajror, gomave te automjeteve të transportit tokesor, ajror, dhe te mjeteve bujqesore, bateri te te gjitha llojeve. Import-eksport i mallrave të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë dhe përdorim shtëpiak si: detergjentë, veshmbathje, aksesore etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha produkteve bujqësore organike dhe inorganike, punime të ndryshme në bujqësi, transport i produkteve bujqësore. Import eksport I mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe perdorim shtepiak si, detergjente, tregtim i te gjitha materialeve, veshmbathje, tuba rekorderi, lektropompa si dhe mirembajtja e tyre etj. Tregtimi i aparateve celular, kompjuterave, fotokopje, servera, softuera, scanner, aksesore qe lidhen me to, tregtim te kartave te telefonit dhe servis per celular dhe pajisje elektronike. Tregtim me shumice dhe pakice, te



pajisjeve kompjuterike te te gjitha llojeve. Tregtim i mallrave ushqimor, blegtoral, bujqesor, fruta perime etj. Import aksesoresh dhe elemente prodhime metalike, perpunimin dhe tregtimin e lendes se drurit etj. Shitja me pakice e lendeve djegese (nafte,benzine,lubrifikante,etj). Shitje e biletave për transport tokësor dhe ajror,kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktivitet ne fushen e reklames, ne fushen e botimeve te ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale te tjera publicitare. Prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash.

Tregtim me shumice e pakice, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve te transportit te kapaciteteve te ndryshme qe sherbejne per transportin e mallrave dhe/ose te pasagjereve. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve bujqesore, punime te ndryshme ne bujqesi (mbjellje, korrije, shirje etj), transport i produkteve bujqesore. Eksport-import, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire, te kapaciteteve te ndryshme, me ose pa rimorkio, makineri pajisje industriale.

Hapje dhe shfrytezim i serviseve per riparimin dhe mirmbajtjen e të gjitha llojeve te mjeteve, tokesore, detare, ajrore, hapja pika lavazhi. Investime dhe sherbime ne fushën e pasurive të paluajtshme, duke përfshirë pa u kufizuar, shitje, qiradhenie, riparime, blerje, rimarrje te pasurive te patundshme në Shqiperi. Transporti i lendeve djegese brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise ose te treteve. Aktivitet ne fushen e turizmit, hotelerise, bar, restorant. Furnitura fidanesh, mirembajtje pajisjesh, instalime teknologjike dhe parqesh ekologjike te ndryshme, mirembajtje ambjentesh. Sistemime, transport kartotekash, dosjesh, arshivim dokumentacioni kartotekash. Planifikim, konsultim ne ndertim, mjedis, transport, nfrastrukture, impiante teknike, procesimi i te dhenave ne fushat e lidhura me to, edhe te gjitha aktivitetet e tjera te cilat synojne t'i sherbejne direkt interesit te deges. Veprimtari në fushën e turizmit, transportit, industrisë, etj. Transport i brendshem dhe i jashtem per vete dhe per te trete, etj. Montim çmontim te dekoreve festive, tregtim te fishekzjarreve,tregtim artikuj zbukurimi etj. Evadim te beturinave, kimikateve, lende te rrezikshme ,etj. Tregtim prodhim i ujit etj. Shërbime konsulence ligjore, financiare etj. Zyre kontabiliteti.

Shoqëria, brenda kufijeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Shoqëria mund të hapë veprimtari të reja, të krijojë sipërmarrje të reja ose të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera si brenda ashtu dhe jashtë vendit pa cënuar objektin kryesor të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i normativave të harxhimit të karburantit, të vajit dhe ndërrimit të filtrave për automjete dhe gjeneratore. Vlerësim për nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve te transportit.

Neni 2

Emërtimi

Ortaku kanë vendosur që shoqërinë ta emërtojë **“GAMA INC”**.

Neni 3

Forma juridike

Shoqëria “GAMA INC”, është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe pocedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.



Shoqëria "GAMA INC" SHPK, ka një kapital i cili ndahet në kuota, që është derdhur nga ortaku për të përballuar humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 4

Selia

Shoqëria e ka selinë në Kavajë, me adresë Lagjja nr.1, Bulevardi Josif Budo, objekt 3-katesh, kati i pare, godina nr.291.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale , si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj.

KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT

Neni 6

Të drejtat e shoqërisë dhe ortakëve

Shoqëri ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë kufinjve të saj.

Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

Shoqëri ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri të tjera ose ndërmarrje, Brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm që ka të bëjë me veprimtarinë tregtare, projektuese, realizuese të shoqërisë si bilancet, llogaritë ekonomike etj.

KREU III KAPITALI

Neni 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë e ndare ne 1 kuote te vetme Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë, sipas pjesëmarrjes në kontribute në kapitalin themeltar:



Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut të vetëm mund të jetë në parà ose në natyrë(pasuri të luajtshme/paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 (tre) vjetëve nga çasti i cënimit.

KREU IV ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Vendimet nga ortakët e shoqërisë në Asamblenë e Përgjithshme. Këto veprime shënohen në Librin e Shoqërisë.

Neni 9

Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga Administratori/ja **Znj.Majnela BEQIRI**.

Kohëzgjatja në detyrë e administratorit do të jetë 5(pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit

KREU VI DISPOZITA TË TJERA

Neni 10

Fitimi i realizuar nga shoqëria , pas shlyerjes së detyrimeve ligjore do t'i mbetet ortakëve të shoqërisë në raport me zotërimin e kuotave të kapitalit.

Ky akt redaktohet dhe nënshkruhet ne 4 kopje me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe. Një kopje ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Ortaku i vetëm shoqërisë "GAMA INC" SHPK;

Majnela Beqiri